

VENDIM
Nr. 431, datë 11.11.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 11.11.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Shkodër (UK Shkodër), me shkresën nr. 1463 prot., datë 28.9.2021, dhe “Dokumentacion plotësues”, me shkresën nr. 1477 prot., datë 29.9.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Shkodër në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe “Rregulloren e licencimit”, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Shkodër deklaroi se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 114 086 banorë të Bashkisë Shkodër, si dhe përpunimin e ujërave të ndotura në ITUN Shkodër (Shirokë, Velipojë) me një kapacitet për rreth 56 000 banorë dhe që funksionon për 42 000 banorë të qytetit të Shkodrës zonës së plazhit dhe fshatrat përreth tij;

b) Drejtuesit teknik, z. Lazer Pemaj, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në vitin 1989 dhe ka përvojë në profesion;

c) Drejtuese teknike, znj. Blerina Arrtunda, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Mjedis profili Trajtum Uji në vitin 2017.

4. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Shkodër, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve, si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Shkodër është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a. (me NUIS J66902052A), në kategoritë:

- a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura;
- c) Kategoria D – Për trajtimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

- a) Drejtues ligjor – Mark Molla;
- b) Drejtues teknik – Lazer Pemaj;
- c) Drejtuese teknike – Blerina Arrtunda.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a. është Bashkia Shkodër.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 28.12.2021.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani